



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Gjuhë E Huaj C (2) Frengjisht

Ngarkesa: kredite : 6ECTS; leksione - /seminare: 60

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I: Semestri: II

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim teknik, letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Ky modul kerkon nje angazhim te vazhdueshem nga ana e studentit si dhe nje pjesemarrje aktive gjate seancave pasi mbeshetet ne metoden interaktive te mesimdhënies për përvetësimin e kësaj gjuhe dhe arrijten e nje komunikimi të lirshëm.

Metoda e zgjedhur eshte Alter Ego B2+ e cila do të plotësojë dhe do të thellojë më tej njohuritë e marra paraprakisht si ato gjuhësore, komunikuese edhe kulturore në gjuhën frënge. Studentit do të përvetësojë dhe përmirësojë kompetencat gjuhësore dhe leksikore, kompetencat e të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim dhe me gojë nëpërmjet studimit të teksteve me natyre informues, përshkrues, shpjegues, argumentues. Të kuptuarit me shkrim dhe me gojë, të shprehurit me shkrim dhe me gojë, do të ofrohen nëpërmjet materialeve të ndryshme me natyrë autentike të përshtatur didaktikisht për qëllim të të mësuarit. Do të favorizohet reflektimi i studentit në praktikat gjuhësore me shkrim dhe me gojë. Qasja pedagogjike bazohet në vëzhgimin, në analizën dhe në ndërveprimin. Në këtë mënyrë, studenti do të njhet edhe me elementët kulturor dhe të qytetërimit të gjuhës frënge.

Objektiva specifike lëndore:

- Arritja e nivelit B2 në komunikim sipas parametrave të percaktuara nga Kuadri European i Perbashket per gjuhet;
- Aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në mënyrë të pavarur mbi tema të ndryshme të jetes së përditshme personale dhe profesionale;
- Aftësia për të përzgjedhur dhe përdorur fjalorin perkates mbi temat si shkolla, profesioni, argetimeve etj;
- Aftësia për të treguar një ngjarje në kohën e shkuar dhe për tv shprehur emocione, dëshira apo ndjenja të ndryshme nëpërmjet letrave personale;
- Aftësia për t'u shprehur gojarisht dhe me shkrim në mënyrë të thjeshte mbi tema që kanë tv bëjnë me pervoja e ngjarje, endrrat e shpresat apo qellimet tona apo te shprehim dhe reagimet e opinionet tona mbi nje ngjarje.

Rezultate të pritshme:

- Aftësi komunikimi me gojë e me shkrim, aftesi per te kuptuar dhe lexuar tekste te ndryshme sipas parametrave te percaktuara per nivelin B2;
- Kompetenca shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për tema te ndryshme sociale e kulturore;
- Kompetenca ndërkulturore: njohja e kulturave te ndryshme dhe e diversitetit kulturor.
- Të kuptojnë pikat kryesore të një diskutimi kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura në punë, shkollë, kohë të lirë etj.;
- Të jetë në gjendje të prodhojë një ligjërime të thjeshtë dhe koherente për tema të njohura dhe në fushat e tij të interesit